**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

#### **D. DHËNIA E KONTRATËS**

##### **23. Njoftimi i Fituesit**

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

##### **24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet

para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

#### **DH. ANKESAT**

#### **25. Procedura e ankesës**

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

#### **26. Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës  
Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9:

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

**Shtojca 1.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>5</sup>**

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
  - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
    1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
    2. Njoftimin e Kontratës;
    3. Kriteret e Përzgjedhjes;
    4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;

<sup>5</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):**  
\_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total (3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total</b>				_____

---

<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>	
<b>TVSH (%)</b>	
<b>Çmimi total me TVSH:</b>	
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

**Shtojca 3.**

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]  
 [ *Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve* ]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: [ *Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor* ]

Në emër të: [ *Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar* ]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [ *lloji i procedurës* ]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ *objekti* ]

Publikimi ( *nëse zbatohet* ): Buletini i Njoftimeve Publike [ *Data* ] [ *Numri* ] / Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.*

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [ *emri i autoritetit/entit kontraktor* ] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [ *njoftimin e kontratës* ].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

**Shtojca 4.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës

tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

#### **Shtojca 5.**

*(<sup>6</sup>Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)*

### **DEKLARATË**

#### **Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt ..... është i pamiruar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

<sup>6</sup> Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 6.**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor* ]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Referohuni dokumentave të ngarkuara në **SPE**

### **Shtojca 7.**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

## **FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

Shërbimi që kërkohet: “Sigurimi i Pasurisë”,

**Afatet e ekzekutimit:** 16 (gjashtëmbëdhjetë) muaj dhe do të fillojë nga data e prerjes së polices së parë. Përfundimi i afatit të kontratës së prokurimit do të jetë data e përfundimit të afatit të sigurimit të polices së fundit të prerë, objekt i sigurimit të kësaj kontrate.


### ➤ **Në fazën e dorëzimit:**

1. Policat e sigurimit duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe angleze.
2. Përsa i perket raportimit, në rast ndodhje të ngjarjeve, kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:
  - a. Caktimi i një personi kontakti për komunikim në çdo rast;
  - b. Mënyrën e raportimit në rast ndodhje të dëmit.

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

**Dokumentet e paraqitura në gjuhë tjetër nga Shqip ose Anglisht, duhet të shoqërohen me përkthimin e noterizuar në gjuhët Shqip ose Anglisht.**

Shiko dokumentacionin ngarkuar ne SPE

#### **LISTA E OBJEKTEVE TE APD PER T'U SIGURUAR**

NR	EMERTIMI	VLERA
1	EL-VINCA	1,473,837,242
2	MJETE TRANSPORTI-MAKINERI	47,954,842
3	PAJISJE NE KABINA ELEKTRIKE	6,822,065
4	NDERTESA	2,309,045,480
5	SISTEMET E SIGURISE	12,214,349
6	PAJISJE ZYRE NE PERDORIM, DEPO	82,249,047
7	PERGJEGJESIA PUBLIKE DHE E PRODUKTIT	100,000,000
	TOTAL	<b>4,032,123,024</b>

**Periudha e sigurimit 12 muaj**

Rreziqet e Siguruara: Sipas percaktimeve ne klasat e licencave te miratuara me ligj ne AMF-ja

## LISTA E ELEKTROVINCAVE TE APD PER T'U SIGURUAR

NR	NR ASETI	OBJEKTI I SIGURIMIT	DATA NDERTIMIT/BLERJES	VLERA me 31/12/2025	PER TU SIGURUAR NGA	SHUMA E SIGURUAR (%)	CMIMI I OFRUAR
1	38949	ELEKTROVINC NR 1 E/V 10 T (A1)	2002	68,225,804	TPL + ZJARR +DEME NGA PALET E TRETA + STUHI+Rreshqitje Toke+ Demet si pasoje e mospershtatjes se pjeseve, difekteve.	100%	
2	38957	ELEKTROVINC NR 3 E/V 10 T (A2)	2002	87,432,996	TPL + ZJARR +DEME NGA PALET E TRETA + STUHI+Rreshqitje Toke+ Demet si pasoje e mospershtatjes se pjeseve, difekteve.	100%	
3		ELEKTROVINC BMP 7 NR 25	1977	-	TPL	100%	
4	38922	ELEKTROVINC BMP 7 NR 29	1981	2,626,455	TPL + ZJARR +DEME NGA PALET E TRETA + STUHI+Rreshqitje Toke+ Demet si pasoje e mospershtatjes se pjeseve, difekteve.	100%	
5		ELEKTROVINC GANZ NR 10	1960	-	TPL	100%	
6		ELEKTROVINC GANZ NR 11	1960	-	TPL	100%	
7		ELEKTROVINC GANZ NR 18	1965	-	TPL	100%	
8		ELEKTROVINC GANZ NR 19	1965	-	TPL	100%	
9	148081	Reachsteaker SANY SRSC45 G5 RS4505CC0591/148081 45 ton	2023	34,485,000	TPL	100%	
10	146253	Vinç MHC 2120 C1644/146253 125 ton	2022	306,749,145	TPL + ZJARR +DEME NGA PALET E TRETA + STUHI+Rreshqitje Toke+ Demet si pasoje e mospershtatjes se pjeseve, difekteve.	100%	
11	148099	Vinç IMHC 2120 C1656/148099 125 ton	2023	379,661,283	TPL + ZJARR +DEME NGA PALET E TRETA + STUHI+Rreshqitje Toke+ Demet si pasoje e mospershtatjes se pjeseve, difekteve.	100%	
12	123836	Reachstacker RS5 DRF45060S5 T34113.1247/ 123836 45 ton	2007	4,017,435	TPL	100%	
13	123844	Reachstacker RS6 DRF45065S5 A11300332 / 123844 45 ton	2010	6,293,052	TPL	100%	
14	123908	Reachstacker FTMH FT 45-60 500713 / 123908 45 ton	2016	12,239,299	TPL	100%	
15	39116	Reachstacker MYJACK CS 45 KS 500926 45 ton	2002	11,645,572	TPL	100%	
16	123801	Mbajtës Kontejnerësh bosh DCF10045E6 B3010009/123801 10 ton	2012	2,998,272	TPL	100%	
17		Mbajtës Kontejnerësh bosh DCD70-40E5 T33103.2308 10 ton	2007	2,998,272	TPL	100%	
18	38965	Vinç MHC 200 44195/38965 120 ton	2004	113,553,634	TPL + ZJARR +DEME NGA PALET E TRETA + STUHI+Rreshqitje Toke+ Demet si pasoje e mospershtatjes se pjeseve, difekteve.	100%	
19	38973	Vinç MHC 115 44257/38973 65 ton	2008	114,837,657	TPL + ZJARR +DEME NGA PALET E TRETA + STUHI+Rreshqitje Toke+ Demet si pasoje e mospershtatjes se pjeseve, difekteve.	100%	
20	124011	Tërheqës Iveco Magirus 440S42 WJMM1VSH40C254979/124011 40 ton	2013	532,546	TPL	100%	
21	124020	Tërheqës Iveco Magirus 440S42 WJMM1VSH40C254979/124020 40 ton	2013	532,546	TPL	100%	
22	124038	Tërheqës Iveco Magirus 440S42 WJMM1VSH40C254979/124038 40 ton	2013	532,546	TPL	100%	
23	123799	Rimorkio Seit-Usta 123967 50 ton	2013	749,563	TPL	100%	
24	123967	Rimorkio Seit-Usta 123975 50 ton	2013	749,563	TPL	100%	
25	123975	Rimorkio Seit-Usta 123983 50 ton	2013	749,563	TPL	100%	
26	123983	Rimorkio Seit-Usta 123991 50 ton	2013	749,563	TPL	100%	
27	123991	Rimorkio Seit-Usta 124003 50 ton	2013	749,563	TPL	100%	
28	124003	Rimorkio Seit-Usta 123799 50 ton	2013	749,563	TPL	100%	

29	146261	Vinc portual MHC 80 ton IMHC1580 + Grifer elektro hidraulik Negrini ne serial C1640	2022	319,978,353	TPL + ZJARR + DEME NGA PALET E TRETA + STUHI + Rreshqitje Toke + Demet si pasoje e mospershtatjes se pjeseve, difekteve.	100%	
		<b>TOTAL</b>		<b>1,473,837,242</b>			

## LISTA E PAJISJEVE ELEKTRIKE NE KABINA TE APD PER T'U SIGURUAR

NR	OBJEKTI I SIGURIMIT	DATA NDERTIMIT/B LERJES	VLERA me 31/12/2025	PER TU SIGURUAR NGA	SHUMA E SIGURUAR (%)	CMIMI I OFRUAR
1	Pajisje brenda KABINES ELEKTRIKE KT 1	1995 1996 2008	212,856	Te gjitha rreziqet perfshire "Zjarr, rrufe, eksplozion, Renie Avionesh apo pjese te tij mbi pasurine, demtimet aksidentale nga mbitensioni, stuhia, permbytja, temeti. Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
2	Pajisje brenda KABINES ELEKTRIKE KT 2	1995 1996 2008	71,583	Te gjitha rreziqet perfshire "Zjarr, rrufe, eksplozion, Renie Avionesh apo pjese te tij mbi pasurine, demtimet aksidentale nga mbitensioni, stuhia, permbytja, temeti. Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
3	Pajisje brenda KABINES ELEKTRIKE KT 3	1995 1996 2008	2,738,297	Te gjitha rreziqet perfshire "Zjarr, rrufe, eksplozion, Renie Avionesh apo pjese te tij mbi pasurine, demtimet aksidentale nga mbitensioni, stuhia, permbytja, temeti. Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
4	Pajisje brenda KABINES ELEKTRIKE KT 4	1995 1996 2008	328,195	Te gjitha rreziqet perfshire "Zjarr, rrufe, eksplozion, Renie Avionesh apo pjese te tij mbi pasurine, demtimet aksidentale nga mbitensioni, stuhia, permbytja, temeti. Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
5	Pajisje brenda KABINES ELEKTRIKE KT 5	1995 1996 2008	288,152	Te gjitha rreziqet perfshire "Zjarr, rrufe, eksplozion, Renie Avionesh apo pjese te tij mbi pasurine, demtimet aksidentale nga mbitensioni, stuhia, permbytja, temeti. Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
6	Pajisje brenda KABINES ELEKTRIKE KT 6	1995 1996 2008	87,015	Te gjitha rreziqet perfshire "Zjarr, rrufe, eksplozion, Renie Avionesh apo pjese te tij mbi pasurine, demtimet aksidentale nga mbitensioni, stuhia, permbytja, temeti. Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
7	Pajisje brenda KABINES ELEKTRIKE KT 7	1995 1996 2008	133,635	Te gjitha rreziqet perfshire "Zjarr, rrufe, eksplozion, Renie Avionesh apo pjese te tij mbi pasurine, demtimet aksidentale nga mbitensioni, stuhia, permbytja, temeti. Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
8	Pajisje brenda KABINES ELEKTRIKE KT 12	2022	2,399,867	Te gjitha rreziqet perfshire "Zjarr, rrufe, eksplozion, Renie Avionesh apo pjese te tij mbi pasurine, demtimet aksidentale nga mbitensioni, stuhia, permbytja, temeti. Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
9	Pajisje brenda KABINES ELEKTRIKE KT 14	1995 1996 2008	150,210	Te gjitha rreziqet perfshire "Zjarr, rrufe, eksplozion, Renie Avionesh apo pjese te tij mbi pasurine, demtimet aksidentale nga mbitensioni, stuhia, permbytja, temeti. Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
10	Pajisje brenda KABINES ELEKTRIKE KT 15	1995 1996 2008	412,254	Te gjitha rreziqet perfshire "Zjarr, rrufe, eksplozion, Renie Avionesh apo pjese te tij mbi pasurine, demtimet aksidentale nga mbitensioni, stuhia, permbytja, temeti. Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	

---

TOTAL		6,822,065		
-------	--	-----------	--	--

## LISTA E MJETEVE TRANSPORTI DHE MAKINERIVE TE APD PER T'U SIGURUAR

NR		OBJEKTI I SIGURIMIT	DATA NDERTIMIT/ LERJES	VLERA me 31/12/2025	PER TU SIGURUAR NGA	FUQIA MOTORIKE	SHUMA E SIGURUAR (%)	CMIMI I OFRUAR
1	39159	AUTOMARKETI 50T DR3918 E	1995	995,116	TPL+KASKO	190 Kw	100%	
2	39781	ZJARREFIKESE IVECO DR 6117 E	2008	828,096	TPL+KASKO	201 Kw	100%	
3	39790	ZJARREFIKESE IVECO DR 6118 E	2008	784,512	TPL+KASKO	201 Kw	100%	
4	39693	AUTOVETURE TIGUANE 1 AA 022 AE	2008	79,931	TPL+KASKO	103 Kw	100%	
5	39706	AUTOVETURE TIGUANE 2 DR 6434 E	2008	79,931	TPL+KASKO	103 Kw	100%	
6	39714	AUTOAMBULANCE CRAFTER AA 523 AC	2011	407,290	TPL +KASKO	80 Kw	100%	
7	100538	Pick up me vinc VW DR 8557 E	2009	227,424	TPL+KASKO	2459 cc	100%	
8	39095	Lifterak Hyster 10 t Nr. 20	2002	309,232	TPL+KASKO		100%	
9	39108	Lifterak Hyster 10 t Nr. 21	2002	309,232	TPL+KASKO		100%	
10	98386	Autoverure Hyundai Minibus Modeli H1 AA420JU	2014	291,234	TPL+KASKO		100%	
11	100458	Skaf Ranieri CLF 25 ITRNI C5044 K 415	2015	1,142,696	TPL+KASKO		100%	
12	112774	Autoveture Ford Fiesta AA 983 RK	2017	331,245	TPL+KASKO		100%	
13	112782	Ford Ranger Pick Up AA 897 RK	2017	725,484	TPL+KASKO		100%	
14	115895	Zjarrfikese RENAULT D12 4x2 AA489 SI	2017	6,649,283	TPL+KASKO	180 KW	100%	
15	112918	Ambulance FORD Transit AA243RS	2017	1,875,640	TPL+KASKO		100%	
16	112803	Furgon Ford Transit AA 895 RK	2017	663,198	TPL+KASKO		100%	
17	112811	Fouristrade VOLVO XC60 AA 550 AI	2017	1,167,852	TPL+KASKO		100%	
18	123959	Pirun Linde H35D		460,414	TPL+ZJARR	44 KW	100%	
19	134201	VW Amarok AB 611 ER		1,349,222	TPL+KASKO	2000 cc	100%	
20	134210	Kia Sportage AB 763 ER		1,441,382	TPL+KASKO	1600 cc	100%	
21	145066	Hyundai Tucson HEV AB 770 GT		1,902,528	TPL+KASKO	1600 cc	100%	
22	150199	KIA NIRO ELEKTRIKE AB 209 ML	2023	3,178,200	TPL+KASKO		100%	
23	150201	KIA NIRO ELEKTRIKE AB 194 ML	2023	3,178,200	TPL+KASKO		100%	
24	150210	KIA NIRO ELEKTRIKE AB 225 ML	2023	3,178,200	TPL+KASKO		100%	
25	98394	Autoveture (ix35) AA 438 JV	2014	247,304	TPL+KASKO		100%	
26	157892	Pirun Linde E50/600HL	2025	8,075,999	TPL+KASKO		100%	
27	157905	Pirun Linde E50/600HL	2025	8,075,999	TPL+KASKO		100%	
		<b>TOTAL</b>		<b>47,954,842</b>				

## LISTA E NDERTESAVE TE APD PER T'U SIGURUAR

NR	OBJEKTI I SIGURIMIT	DATA NDERTIMIT/B LERJES	VLERA me 31/12/2025	Siperfaqja ne M2 e shkelur	PER TU SIGURUAR NGA	SHUMA E SIGURUAR (%)	CMIMI I OFRUAR
1	Administrata 6	1978	28,846,828		Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
2	Administrata 1 DREJTORIA E APD	1938	32,964,488		Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
3	Administrata 3 INTERKLUBI(ex)	1970	28,783,440		Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
5	Administrata 5 (Dega e Doganes Durres)	1987	1,422,872		Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
6	Administrata 2	1938	8,631,070		Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
7	Administrata 4 ZYRAT E OFICINES 3- KATESHE	1962	3,573,860		Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
8	MAGAZINA 1	1962	14,875,642		Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
9	TORNERIA	1964	8,795,963		Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	

NR	OBJEKTI I SIGURIMIT	DATA NDERTIMIT/B LERJES	VLERA me 31/12/2025	Siperfaqja ne M2 e shkelur	PER TU SIGURUAR NGA	SHUMA E SIGURUAR (%)	CMIMI I OFRUAR
10	HYRJA NR 2	2009	3,419,114		Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
11	Hyrja Nr. 4 (Tetoja e hyrjes)	2013	16,068,284		Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
16	KALATA NR 5	2004	377,361,071		Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
17	KALATA NR 6	2004	425,121,849		Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
18	KALATA NR 9/A	2002	145,947,733		Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
19	KALATA NR 9/B	2002	183,399,593		Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
20	Administrata 9 PMNZSH	2008	6,360,492		Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
22	Kapanoni i Parkut	2009	6,900,649		Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	

NR	OBJEKTI I SIGURIMIT	DATA NDERTIMIT/B LERJES	VLERA me 31/12/2025	Siperfaqja ne M2 e shkelur	PER TU SIGURUAR NGA	SHUMA E SIGURUAR (%)	CMIMI I OFRUAR
23	KALATA NR 0	1962	8,173,531		Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te asetëve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
24	KALATA NR 1	1962	24,971,904		Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te asetëve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
25	KALATA NR 2	1950	22,066,115		Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te asetëve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
26	KALATA NR 3	1950	1,295,351		Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te asetëve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
27	KALATA NR 4	1950	23,657,776		Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te asetëve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
28	KALATA NR 7&8 dhe Rehabilitimi	1962	58,365,137		Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te asetëve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
29	KALATA NR 10	2013	682,992,920		Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te asetëve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
30	KALATA NR 11	1994	108,638,483		Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te asetëve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	

NR	OBJEKTI I SIGURIMIT	DATA NDERTIMIT/B LERJES	VLERA me 31/12/2025	Siperfaqja ne M2 e shkelur	PER TU SIGURUAR NGA	SHUMA E SIGURUAR (%)	CMIMI I OFRUAR
31	Zyra modulare per agjensite doganore		86,411,317		<b>Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare</b>	100%	
<b>TOTAL</b>			<b>2,309,045,480.24</b>				

## SISTEMET E SIGURISE SE APD-SE

INFRASTRUKTURE SIGURISE (FSPD)		VLERA me 31/12/2025	PER TU SIGURUAR NGA	SHUMA E SIGURUAR (%)	CMIMI I OFRUAR
1	<i>Tot.Implementim I forcave te sigurise/1 -Rrjeti I fibrave optike</i>	903,345	Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 dhe 9 te sigurimit te aseteteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
2	<i>Tot.Implementim I forcave te sigurise/2-Qendra e Mbikqyrjes</i>	1,779,937	Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 dhe 9 te sigurimit te aseteteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
3	<i>Tot.Implementim I forcave te sigurise/3-Sistemi CCTV</i>	5,741,873	Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 dhe 9 te sigurimit te aseteteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
4	<i>Tot.Implementim I forcave te sigurise/4-Kontrolli I hyrjeve</i>	3,789,194	Te gjitha rreziqet Bazuar ne klasen 8 dhe 9 te sigurimit te aseteteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
<b>TOTALI</b>		<b>12,214,349</b>			

**LISTA E PAJISJEVE TE ZYRAVE TE APD PER T'U  
SIGURUAR**

NR	OBJEKTI I SIGURIMIT	DATA NDERTIMIT/B LERJES	VLERA me 31/12/2025	PER TU SIGURUAR NGA	SHUMA E SIGURUAR (%)	CMIMI I OFRUAR
10	INVENTARI EKONOMIK NE PERDORIM & DEPO		82,249,047	Te gjitha rreziqet perfshire zjarr, termeti. Bazuar ne klasen 8 te sigurimit te aseteve sipas urdherave te Autoritetit te mbikqyrjes financiare	100%	
	<b>TOTAL</b>		<b>82,249,047</b>			

PERIUDHA SIGURIMIT	LIMITI I PERGJEGJESISE PER CDO NGJARJE	MBULIMI	PRIMI I SIGURIMIT
1 VJECARE	100,000,000 leke	*PERGJEGJESI PUBLIKE DHE PRODUKTI	

\*Per te gjitha ngjarjet gjate gjithe vitit, jo me shume se 200,000,000 leke per te gjitha ngjarjet

---

**Shtojca 8.**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

**FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

- Shiko dokumentacionin ngarkuar ne SPE

**TERMAT E REFERENCES PER SIGURIMIN E PASURISË TË APD**

**Rreziqet që kërkohen të mbulohen nga polica e sigurimit:**

**SHKAKTARËT E HUMBJES, DËMTIMIT APO SHKATËRRIMIT TË PASURISË SË SIGURUAR TË APD, NË MËNYRË TË PAPRITUR, TË PAPARASHIKUAR DHE AKSIDENTALE MUND TË JENË:**

**TERMETI**

---

Termeti duhet te jete i regjistruar nga stacionet sizmike, si dhe te kete nje vlere jo me te vogel se 4 Balle sipas shkalles Rihter.

Shuma e siguruar e termetit te jete 100 % e vleres aktuale te objektit.

Objektet e siguruara nga Termeti perfshijne Objektet ne:

- Tabelen 5- Ndertesa
- Tabelen 2- Pajisje zyra dhe elektrike ne kabina
- Tabelen 6- Sistemet e Sigurise
- Tabelen 7- Inventari ekonomik ne perdorim dhe depo

sipas pershkrimit ne kolonen perkatese te shtojcen Nr 3.

---

## **STUHIA**

Stuhi do te konsiderohet nje levizje ajri me force jo me te vogel se 8 balle (17.2m ne sekond ose 62 km ne ore) shkaktuar nga kushtet metereologjike. Ne qofte se nuk ka matje nga stacionet metereologjike qe kjo force ere mbizoteron kur ndodh kjo ngjarje ,do te jete e mjaftueshme nqs APD sjell te dhena.

Siguruesi do te paguaje demshperblimin per objektet e siguruara, te cilat jane shkaterrua ose demtuar nga stuhia, nese shkaterrimi ose demtimi :

- Shkaktohet nga ndikimi direkt i stuhise ose
- Shkaktohet nga stuhia, duke hedhur pjese te nderteses, peme ose objekte te tjera brenda objekteve te siguruara ose nderteses ne te cilin jane vendosur objektet e siguruara ose
- Eshte pasoje e humbjes ose demit te shkaktuar nga stuhia ne objekte e siguruara ose ne elemente te ketyre objekteve.

Shuma e siguruar e stuhise te jete 100 % e vleres aktuale te objektit.

Objektet e siguruara nga Stuhia perfshijne Objektet ne:

- Tabelen 1- Elektrovinca
  - Tabelen 2- Pajisje zyra dhe elektrike ne kabina
  - Tabelen 5- Ndertesa
  - Tabelen 6- Sistemet e Sigurise
  - Tabelen 7- Inventari ekonomik ne perdorim dhe depo
- sipas pershkrimit perkates ne shtojcen Nr 3
- 

## **ZJARRI DHE RREZIQET SHTESE TE TIJ**

- 
- Zjarr do te konsiderohet te jete nje forme e djegies me flake e te mirave materiale, e afte te vetepohet dhe te vetezgjerohet .  
Ky perkufizim perfshin cdo forme te lindjes, dhe krijimit te zjarrit dhe qe prek objektet e siguara nga zjarri sipas Shtojces nr 3.
  - Rrufe do te konsiderohet te jete nje shkrepje e rrufese e cila godet nje object direct ose indirekt.
  - Eksplozion do te konsiderohet te jete nje clirim i papritur i energjise i shkaktuar nga forca e gazrave ose avujve ne perpjekje per zgjerim. Ne se shkak per shperthimin brenda enes eshte nje reaksion kimik, atehere do te demshperblehet cdo demtim i enes, dhe ne se paretet e saj nuk jane shkaterruar.
  - Renie avionesh apo pjese te tij.

Shuma e siguruar e zjarrit te jete sipas percaktimeve ne Listen bashkangjitur si Shtojca 3.

Objektet e siguruara nga Zjarri perfshijne Objektet/ pajisjet/materialet ne:

- Tabellen 1- Elektrovina
- Tabellen 2- Pajisje zyra dhe elektrike ne kabina
- Tabellen 4- Mjete Transporti dhe makineri,
- Tabellen 5- Ndertesa
- Tabellen 6- Sistemet e Sigurise
- Tabellen 7- Inventari ekonomik ne perdorim dhe depo sipas pershkrimit perkates ne shtojcen Nr 3

---

## **RRESHQITJA E TOKES**

Ky sigurim mbulon humbjen ose demin per shkak te rreshqitjes se siperfaqes se tokes ne zona te pjerreta, me plasaritje dhe çarje ne forme damarësh, qe shihen qarte, te cilat ne periudha te shkurtera kohe shkaktojne deformacione statike te rrezikshme ose çarje te medha ne ndertesat.

Shuma e siguruar e zjarrit te jete Vlera e mbetur ne Bilanc dhe Vlera e rikthimit te objektit ne gjendjen para demit, te detajuara keto sipas percaktimeve ne Listen bashkangjitur si Shtojca 3.

Objektet e siguruara nga Rreshqitja e Tokes perfshijne Objektet/ pajisjet/materialet ne:

- Tabellen 1- Elektrovina
- Tabellen 2- Pajisje zyra dhe elektrike ne kabina
- Tabellen 4- Mjete Transporti dhe makineri,

- 
- Tabelen 5- Ndertesa
  - Tabelen 6- Sistemet e Sigurise
  - Tabelen 7- Inventari ekonomik ne perdorim dhe depo sipas pershkrimet perkates ne shtojcen Nr 3
- 

### **MBULIM SHTESE – Demi ne Aparaturat dhe paisjet i shkaktuar nga rryma elektrike**

Ky sigurim mbulon:

1. Dëmin në çdo makineri dhe aparature elektrike dhe elektronike, ose në çdo pjesë të instalimit elektrik dhe elektronik të shkaktuar nga rryma elektrike me ose pa ndodhjen e zjarrit,
2. Dëmin në çdo makineri dhe aparature elektrike dhe elektronike, ose në çdo pjese të instalimit elektrik/electronik si pasojë e rrufesë, nëse ky dëm nuk është shkaktuar nga goditja direkte ose indirekte e rrufesë.

Shuma e siguruar e Mbulimit Shtese te jete 100 % e vleres aktuale te objektit/pajisjeve/materialeve.

- Pjesen e zbritshme deri ne 5000 Leke.

Objektet e siguruar nga Zjarri Mbulim Shtese perfshijne Objektet/ pajisjet /materialet ne:

- Tabelen 1- Elektrovinca
- Tabelen 2- Pajisje zyra dhe elektrike ne kabina
- Tabelen 5- Ndertesa
- Tabelen 6- Sistemet e Sigurise
- Tabelen 7- Inventari ekonomik ne perdorim dhe depo sipas pershkrimet perkates ne shtojcen Nr 3

---

### **SIGURIMI I DEMENTIMEVE TE MAKINERIVE**

Siguresi demshperblen humbjen ose demtimin fizik te papritur dhe te paparashikuar, qe ben te domosdoshme riparimin ose zevendesimin e makinerive si pasojë e:

- 
1. aksidenteve te rastesishme ne pune te tilla si mospershtatje, lirimi i pjeseve, demtime ose defekte te pjeseve mbrojtese, hyrjes se personave te jashtem.
  2. shkeputje pjesësh si rezultat i forces centrifugale
  3. mungeses se ujit ne boilerat me avull ose eneve me presion
  4. mbi-presionit ose shperthimi
  5. qark i shkurter, mbi-voltazh/ mbi- rryme elektrike
  6. defekteve ne montim
  7. veprimeve e gabuara, mungeses se aftesive, pakujdesise se punonjesve.

Objektet e siguruara nga Demtimet e Makinerive perfshijne Makinerite ne:

- Tabellen 1- Elektrovinca
- Tabellen 2- Pajisje zyra dhe elektrike ne kabina
- Tabellen 6- Sistemet e Sigurise sipas pershkrimimit perkates ne shtojcen Nr 3

Pjesen e zbritshme e pranueshme nga Autoriteti Kontraktor deri ne 5000 Leke.

---

## **SIGURIM KASKO**

Me sigurim kasko te plote nenkuptohehet mbulim i plote i demeve sipas pikave te meposhtme :

- 1-thyerje e xhamave;
- 2-demtime aksidentale;
- 3-zjarr, rrufeja, eksplozioni;
- 4-katastrofa natyrore,
- 5- vjedhje

- Pjesen e zbritshme deri ne 5000 Leke

Mjetet per Sigurim Kasko jane percaktuar ne:

- Tabellen 4- Mjete Transporti dhe makineri sipas pershkrimimit perkates ne shtojcen Nr 3
-

---

## **SIGURIM TPL**

- Pjesen e zbritshme deri ne 5000 Leke

Mjetet per Sigurim TPL jane percaktuar ne:

- Tabelen 1- Elektrovinca
- Tabelen 4- Mjete Transporti dhe makineri sipas pershkrimit perkates ne shtojcen Nr 3

## **DEME NGA PALET E TRETA**

---

Me veprime nga palet e treta do te kuptohet humbja, shkaterrimi ose demtimi aksidental i shkaktuar nga (zjarri, eksplozioni ose te tjera) e Pasurise se siguruar shkaktuar direkt ose indirekt nga palet e treta ( çdo person fizik apo juridik ose grup personash).

Ne Momentin e Ngjarjes se siguruar sipas ketij seksioni, fillimisht Siguruesi paguan demshperblimin karshi te Siguruarit, dhe I Siguruari i jep te drejten Siguruesit per te marre shperblimin nga pala e trete per demin e shkaktuar.

Objektet e siguruara nga Deme nga Pale te Treta perfshijne Objektet/ pajisjet /materialet ne:

- Tabelen 1- Elektrovinca
- Tabelen 5- Ndertesa
- Tabelen 6- Sistemet e Sigurise sipas pershkrimit perkates ne shtojcen Nr 3

---

## **PERGJEGJESI NDAJ PALEVE TE TRETA**

**Pergjegjesi Publike e percaktuar si:**

Demshperblim i te siguruarit ndaj shumave per te cilat i siguruari do te jete ligjerisht i detyrueshem te paguaje per te zhdemtuar aksidente ndaj cdo personi dhe /ose humbje apo demtime te prones te personave te trete ne ambientet e tij.

---

**Limiti i Pergjithshem i demshperblimit do te jete 100,000,000 Leke për cdo ngjarje dhe 200,000,000 Leke per te gjithe periudhen e sigurimit.**

Pjesa e Zbritshme maksimale e pranueshme nga Autoriteti Kontraktor do te jete 5, 000 Leke.

**Përgjegjësi e produktit(aktivitetit), ku përfshihen:**

- 1.Dëmtime trupore(vdekje, sëmundje të/ose një personi)
- 2.Humbje ose dëmtime fizike të sendeve(pasurisë së trupëzuar)
- 3.Përgjegjësia profesionale(dëmtimet e shkaktuara nga el/vincierët dhe drejtuesit e automekanizmave)

Shkaktuar nga shërbimet/mallrat , shitur, furnizuar,instaluar, montuar, riparuar, ndryshuar ose trajtuar nga i siguruari, ndodhur gjatë periudhës së dëmshpërblimit të siguruar, jashtë njësisë së të siguruarit.

**Limiti i Pergjithshem i demshperblimit do te jete 100,000,000 Leke për cdo ngjarje dhe 200,000,000 Leke per te gjithe periudhen e sigurimit.**

Pjesa e Zbritshme maksimale e pranueshme nga Autoriteti Kontraktor do te jete 5, 000 Leke.

---

**Per asetet (sipas listes se objekteve per tu siguruar) te APD-se te cilat ne momentin e lidhjes se kontrates vazhdojne te jene te siguruara, siguracioni i tyre do te kryhet pas mbarimit te siguracionit aktual.**

---

## Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

---

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

*Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.*

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës10;*

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

---

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros minimale vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë në një me vlerë jo më të vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra vlerën e fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

## 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbime të mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

